



Prishtinë/Priština
Nr./Br. 144-2018

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 31.01.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.BENJAMIN EJUPI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Partia Drejtësisë-PD" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Esat Ejupi**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Benjamin Ejupi**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 25.01.2018, nr.119/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Esat Ejupi, pas dorëheqjes së tij të përvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirënditur, i cili është **z.Benjamin Ejupi**, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 31.01.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

